



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIMAL  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2887/prot.

Urë Vajguore, më 14.10.2024

VENDIM

Nr. 50 Datë 14.10.2024

**“Mbi miratimin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar të nëpunësve civil e të punonjesve aministrativë të njësive të Vetëqeverisjes Vendore, sipas VKM Nr.503 datë 1.8.2024”.**

Këshilli i Bashkisë Dimal, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2024 mbi bazën e materialit të paraqitur nga Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës mbështetur në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 8 pika 2, 9 pika 1.1.b, 34,35,36,37,40,41,54 pika dh, dhe neni 64 pika c, Ligji nr.68/2017 “Për Financat e vetëqeverisjes Vendore”, neni 45, Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 44, në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat standard të zbatimit të buxhetit” të Udhëzimit plotësues “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, në V.K.B-së Nr.52, dt.2612.2023“Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Dimal për vitin 2024”, si dhe të VKM 503 datë 01.08.2024 për disa ndryshime në VKM 328 datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve , grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore , për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjesve administrativë të njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

VENDOSI :

**Me 13 vota PRO, dhe 1 votë kundër nga 14 Këshilltarë prezentë :**

- I. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit administrativë sipas tabelës bashkëlidhur:**
- II. Të miratojë Shtesë buxheti transferte e pakushtëzuar për vitin 2024 në vlerën 8,922,299 lekë.**

III. Të miratojë Perdorimin e shtesës së buxhetit për vitin 2024 në programet buxhetore si më poshtë :

1. Planifikimi Menaxherial, program 01110 artikulli 600 fond page = 5,000,000 lekë  
artikulli 601 sig. shoq. = 700,000 lekë
2. Bujqësia , program 4240 artikulli 600 fond page = 900,000 lekë  
artikulli 601 sig. shoq. = 200,000 lekë
3. Shërbimi Pyjor , program 4260 artikulli 600 fond page = 100,000 lekë  
artikulli 601 sig. shoq. = 20,000 lekë
4. Planifikimi urban program 06140 artikulli 600 fond page = 1,400,000 lekë  
artikulli 601 sig. shoq. = 150,000 lekë
5. Përkujdesja Sociale program 10430 artikulli 600 fond page = ,400,000 lekë  
artikulli 601 sig. shoq. = 52,299 lekë.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë .
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të Ligjit 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore “, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**  
**AVDULLA SALILLARI**



**BASHKIA DIMAL****NIVELI I PAGAVE PËR PUNONJËSIT E BASHKISË DIMAL VITI 2024****Sipas VKM 503 datë 01.08.2024 për disa ndryshime në VKM 328 datë 31.05.2023****“Për klasifikimin e funksioneve , grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore ,për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar ,të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të Vetëqeverisjes Vendore “.**

Nr	Emertimi i Pozicionit	VKM	Pika Lidhja	Diploma /Klasa	Paga e Pozicionit
1	Kryetar	VKM nr 503	1.ç	----	230,000
2	Nënkryetar	VKM nr 503	1.ç	-----	161,000
3	Këshilltar kryetarit	VKM nr 503	Lidhja nr 6	Niveli /1 III/2	87,500
4	Sekretari Këshillit	VKM nr 503	Lidhja nr 6	Niveli /1 II-2	113,000
5	Sekretar i Përgjithshëm	VKM nr 503	Lidhja nr 6	Niveli/ 1 I-5	113,000
6	Drejtor	VKM nr 503	Lidhja nr 6	Niveli /1 II-2	113,,000
7	P/Sektori, Kryeispektor	VKM nr 503	Lidhja nr 6	Niveli/ 1 III-2	87,500
8	Përgjegjës sektori	VKM nr 503	Lidhja nr 6	Niveli/ 1 III-3	81,500
9	Specialist , Ispektor	VKM nr 503	Lidhja nr 6	Niveli 1,2 ,3 IV--3	56,000
10	P/Sektori, Kryeispektor policia bashkiake	Ligji 89/2022 , 35/2023		I lartë	87,500
11	Ispektor policisë bashkiake me arsim te lartë	Ligji 89/2022 , 35/2023		I larte	56,000
12	Ispektori policisë bashkiake me arsim te mesëm	Ligji 89/2022 , 35/2023		I mesëm	55,000
13	Specialist	VKM nr 503	Lidhja nr 6	Niveli 1,2 ,3 IV--4	50,000

14	Administratore NJ A	VKM nr 503	Lidhja nr 8	Pika 3	105,000
15	Administratore NJ A	VKM nr 503	Lidhja nr8	Pika 4	102,500

**Paga e këshilltarëve të bashkisë Dimal 10% e pagës së Kryetarit të Bashkisë .**

**Paga e kryetarëve të fshatrave të Njësive Administrative 10% e pagës së Administratortit të Njësive Administrative përkatëse.**

1. Shtesa për vjetërsi në punë jepet sipas pikës ç të V.KM 503 datë 01.08.2024 ku 0,6% për vjetërsi 1-10 vitet e para të punës , 0,8% për 11-20 vite punë , 1% për 21-30 vite punë .(punonjësit që janë me arsim të lartë me nivel diploma 1,2,3 )
2. Punonjësit me arsim të mesëm 1% për cdo vit pune deri në 25 vite .

Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit të lartë

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	<b>Diplomë e arsimit të lartë:</b>	
1	Niveli 7 i KSHK i Master i Shkencave Master i Arteve Master Profesional të përfutuar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohezgjatje normale 2 vite akademike ( Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë )	14 000 lekë
2	Niveli 7 i KSHK Master profesional (Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë )	12 000 lekë
3	Niveli 6 i KSHK Bachelor (Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë)	10 000 leke

**KRYETAR I KËSHILLIT  
AVDULLA SALILLARI**



Adresa: Rruga "Dimal"  
Lagjia "18 Tetori" Ura Vajgurore

Telefon/fax 036122468  
email: bashkia@bashkiadimal.gov.al